

# MPB DORËZUJ PËRGJIGJE DERI TE ASHMAA

**Shkup, 22.07.2019** – Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale e njofton opinionin publik se Ministria e Punëve të Brendshme ka dorëzuar përgjigje në lidhje me kërkesën për informacione nëse personi Bojan Jovanovski pronar i 1 TV ka qenë i mbrojtur nga kjo ministri .

Në përgjigje është theksuar se MPB-ja nuk ka ndërmarë as njëlloj mase dhe aktivitete për mbrojtjen dhe sigurimin e personit përkatës, në bazë të së cilës asnjë punonjës policie nuk është angazhuar për sigurimin dhe mbrojtjen e tij personale.

Agjencia vazhdon me procedurën për përcaktimin e situatës aktuale për partneritet të mundshëm të fshehtë në 1 TV, për këtë arsye u drejtua tek Prokuroria Publike për ndjekjen e krimit dhe korupcionit të organizuar. Informacione do të kërkohen gjithashtu edhe nga institucionet e tjera.

Në drejtim të mbrojtjes së interesit publik dhe zbardhjes së rastit nga pikpamja rregullatore, presim që bashkëpunimi me institucionet e tjera relevante të jetë në nivel të lartë.